

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Fillimisht uroj të gjithë kolegët deputetë për sesionin e ri parlamentar, duke shpresuar që në këtë sesion të ngarkuar parlamentar të tregojmë më shumë maturi, më shumë etikë profesionale, më shumë etikë në komunikim, në respekt të besimit që qytetarët e këtij vendi na kanë dhënë për t'i përfaqësuar dhe përgjegjesisë që kemi për të trajtuar dhe për të vendosur për problemet dhe shqetësimet e tyre. Është momenti të vendosim një standard tjetër, për të dhënë shembullin tonë si deputetë të një vendi anëtar të NATO-s dhe, më afër se kurrë, në realizimin e aspiratës për të qenë anëtar i Bashkimit European, larg gjuhës së urrejtjes dhe larg dhunës verbale.

Më vjen mirë që edhe akti i parë, që diskutojmë dhe miratojmë në këtë sesion parlamentar, lidhet me vendimmarrjen historike të 19 korrikut, të Bashkimit European për Shqipërinë, me mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare, duke bërë të mundur zbatimin e vendimit politik të ndërmarrë 3 vjet më parë për hapjen e negociatave për vendin tonë. Ky akt normativ është miratuar në Komisionin e Integritimit European, si komision përgjegjës, me qëllim që të përshtatë aspektet protokollare dhe ceremonialin shtetëror për sa u përket simboleve të Bashkimit European. Pavarësisht kësaj, simboli i vendosjes së flamurit të Bashkimit European krahas flamurit tonë, nuk është thjesht një aspekt protokollar apo ceremonial, por shënon një gur kilometrik në procesin e rëndësishëm të aspiratave të anëtarësimit të Shqipërisë në familjen e madhe europiane.

Vendosja e flamurit të Bashkimit European krahas flamurit tonë është një nder dhe privilegj për vendin tonë, por, njëkohësisht, është përgjegjësi dhe reflektim për shtetin shqiptar. Qeveria

shqiptare bart përgjegjësinë kryesore të këtij procesi të ri shumëdimensional ku kemi hyrë, ku hapja dhe mbyllja e kapitujve, realizimi i kushteve dhe rekomandimeve të vendosura nga BE-ja për çdo kriter, si dhe përafrimi i legjislacionit me direktivat e Bashkimit European në çdo fushë, për shtetin e së drejtës, demokracinë, për ekonominë, bujqësinë, transportin, energjetikën e të tjera janë tepër komplekse dhe sfiduese. Parlamenti, gjithashtu, bart përgjegjësinë e institucionit ligjvënës për përafrimin e legjislacionit, por edhe të rolit të pazëvendësueshëm që ka me strukturat e saj kombëtare për integrimin european, duke pasur pranë vetës përfaqësues të të gjitha pushteteve, ashtu si edhe shoqërinë civile.

Nga ana tjetër, strukturat e Kuvendit, si ato politike, edhe ato administrative, duhet të ridimensionojnë metodologjinë, funksionimin dhe rolin e tyre për të pasur jo vetëm një rol të rëndësishëm në këtë proces, por edhe për të shërbyer, për të përshpejtuar realizimin e të gjitha rezultateve që priten në këtë proces që sapo ka filluar. Duhet një reflektim për mbivendosjen e përgjegjësive dhe rolit të strukturave të Kuvendit, si ato me funksion politik, ashtu edhe ato me funksion administrativ, me qëllim që të maksimizojmë rezultatet në këtë proces. Rritja e kapaciteteve administrative edhe në strukturat e Kuvendit duhet të jetë prioritet, duke i riorganizuar sipas detyrave dhe përgjegjësive që ato do të kenë në këtë proces të ri.

E parë edhe në përgjegjësinë time, si nënkryetare e Komisionit të Integritimit European, ky komision duhet të rishikojë rolin e tij, jo vetëm në aktivitetin që ka kryer dhe kryen për përafrimin e legjislacionit, por edhe në lidhshërinë që duhet të tregojë në vendosjen e bashkëpunimit me komisionet e çështjeve europiane të vendeve të reja anëtare të Bashkimit European, si dhe homologëve tanë në rajon. Shkëmbimi i përvojës me vende, si: Kroacia, Bullgaria, Rumania e të tjera dhe huazimi i ekspertizës së tyre teknike dhe metodologjisë së këtij procesi janë jetike në një proces të tillë kaq kompleks. Ne, si Komisioni i Integritimit European, duhet të nxisim ekspertët nga fusha akademike, të shoqërisë civile, për t'u bërë pjesë e këtij procesi, nëpërmjet ekspertizave të drejtpërdrejta apo edhe opinionëve të tyre.

Komisioni i Integritimit European duhet të jetë, gjithashtu, pranë studentëve të drejtësisë, të shkencave sociale dhe të të gjitha fushave, pedagogëve, mësuesve për të zhvilluar debate, biseda për rëndësinë e procesit, në të cilin kemi hyrë, për t'u dhënë perspektivën europiane për

vendin tonë. Aspirata europiane është një prioritet kombëtar dhe kërkon angazhimin e të gjithëve dhe mbështetjen e qytetarëve. Besoj se ato që përmenda më sipër, do të jenë pjesë e diskutimeve të komisionit të posaçëm për rishikimin e ligjit të vitit 2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, vendimi për ngritjen e të cilit është bërë pjesë edhe e kësaj seance, për të mos humbur kohë dhe për të filluar sa më shpejt rishikimin e këtij ligji.

Ne kemi përgjegjësinë të përfundojmë sa më shpejt procesin për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian. Jemi të vetëdijshëm që nuk arrihet me një vit apo me dy, por nëpërmjet angazhimit tonë dhe me një koordinim shumë të kujdesshëm, të paktën të jemi të ngjashëm me vendet që e kanë përfunduar me sukses dhe në kohë rekord këtë proces. Përgjegjësi dhe reflektim duhet nga të gjithë aktorët politikë, ku prioriteti i aspiratës europiane të mos përdoret për debate politike në shërbim të agjendës partiake, por në shërbim të procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Për këtë arsye, do t’i ftoja të gjithë kolegët ta votonin këtë akt normativ, i cili, për shkak të emergjencës, ka marrë fuqi dhe është në zbatim. Faleminderit!